



Drejtuar:
Znj. Delina Ibrahimaj
Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Për dijëni:
Znj. Edona Bilali
Ministre Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Për dijëni:
Znj. Mirlinda Karçanaj
Drejtor i Përgjithshëm
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Për dijëni:
Znj. Pranvera Fagu
Drejtor i Përgjithshëm
Qendra Kombëtare e Biznesit

Prot. N. U/2022/ 0198
Tiranë, 03/06/2022

E nderuar zonja Ministre,

Confindustria Albania- Shoqata e Industrialistëve Italianë në Shqipëri ndjek nga afër çdo ndryshim legjislativ që i përket biznesit dhe sipërmarrjes private në Shqipëri dhe mbështet çdo iniciativë të re që ka të bëjë me përmirësimin e klimës së biznesit.

Aplikimet online nëpërmjet portalit e-albania, që janë bërë të detyrueshme dhe pa asnjë alternativë tjetër që nga data 1 maj, po i krijojnë biznesit vështirësi të panumërta.

CONFINDUSTRIA ALBANIA

Associazione degli Industriali Italiani in Albania
Sede: Rruga Themistokli Gërmenji, Pallati Frasheri, shkalla 1, ap 12, Tirana, Albania

info@confindustriaalbania.it
www.confindustriaalbania.it

Tel / Fax. 00355 4 2252687
P.IVA L62412451U

Mbështesim idetë dhe projektet e reja, jemi pro shërbimeve online, por kundër kaosit të krijuar ditët e fundit tek biznesi. Nuk mund të iniciohet me sot me nesër një ndryshim rrënjësor pa lënë mundësi për zgjidhje të tjera alternative, me idenë që, nëse sistemi ka probleme, i rregullojmë rrugës. Rregullimi i problemeve të sistemit online shkakton paqartësi të sipërmarrja, penalizon biznesin për gabime që s’varen prej tij dhe krijon kosto artificiale të paparashikuara dhe të padrejta për sipërmarrjen private. Portali duhet të kishte kaluar përmes një periudhe prove derisa të kolaudohej tërësisht, për të shmangur çrregullimin, kostot dhe mosbesimin tek shërbimet online.

Po sjellim më poshtë disa nga problematikat e hasura nga kompanitë tona anëtare:

- Me ligjin nr. 7/2022 “Për një ndryshim në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, penalitetet për regjistrime të detyrueshme të vonuara u ndryshuan nga 15.000 lekë në 60.000 lekë. Ndërkohë aplikimet online të regjistrimeve të detyrueshme hasin vështirësi të shumta. Portali e-albania shpeshherë edhe me orë të zgjata bllokohet dhe nuk arrin të përdoret. Subjektet penalizohen edhe kur e-albania nuk funksionon për shkaqe të vetë portalit. Të gjitha komunikimet kryhen nëpërmjet postës elektronike. Përgjigjet në lidhje me regjistrimet e detyrueshme, edhe pse duhet të kenë prioritet për të mos penalizuar biznesin, zgjasin nga 5 deri në 10 ditë pune.
- Regjistrimi i ndryshimit të afatit të administratorit shpesh nuk është i vlefshëm edhe në rastin kur është vetë administratori i kompanisë që kryen aplikimin.
- Në rastet kur administratori është i huaj dhe nuk ka asnjë ndryshim në të dhënat e tij/saj, sistemi kërkon dhe pranon vetëm adresë shqiptare. E njëjta problematikë haset edhe në rastet e depozitimit të pasqyrave financiare. Depozitimi i pasqyrave financiare është praktikë e konsoliduar prej vitesh, por pavarësisht kësaj, nuk njihen të dhënat e administratorëve të huaj.
- Në portalin e-albania nuk ekziston shërbimi për rezervimin e emrit, parashikuar në nenin 24 të ligjit “Për regjistrimin e biznesit”. Mungesa e këtij shërbimi sjell si pasojë rritjen e kostove të përgatitjes së dokumentacionit për hapjen e kompanive të huaja.

CONFINDUSTRIA ALBANIA

Associazione degli Industriali Italiani in Albania
Sede: Rruga Themistokli Gërmenji, Pallati Frasheri, shkalla 1, ap 12, Tirana, Albania


- Problematika shfaqen edhe te certifikatat e fiskalizimit, pasi portali jo gjithmonë dërgon imeile automatike për ripërtëritjen e certifikatës. Mungesa e shpeshtë e këtij shërbimi çon në përfundimin e vlefshmërisë së certifikatës, ndërsa afatet e pajisjes me certifikatë të re janë shtyrë në 10 ditë pune, duke krijuar probleme për lëshimin e faturave të fiskalizuara në kohë reale.

Për sa më sipër, kërkojmë me mirësjellje:

1. Të mos aplikohen gjoba dhe penalizime për vonesa të regjistrimit të të dhënave të detyrueshme për një afat 6-mujor, më qëllim që të mundësohet përmirësimi i shërbimeve për sipërmarrjet nga AKSHI;
2. AKSHI dhe QKB-ja të hapin sportelet e asistencës, në mënyrë që zgjidhjet të jenë më të shpejta (praktikë, e cila funksionoi më së miri me Regjistrimin e Pronarit Përfitues);
3. Të shkurtohen afatet për pajisjen me certifikatë fiskale, ose të shtyhet vlefshmëria e certifikatave aktuale edhe për një periudhë 1-6 muaj të tjerë pas datës së skadimit.
4. Të përditësohen dhe të gërshetohen automatikisht të dhënat e administratorëve midis e-tatime dhe e-albania.
5. Të ofrohen të gjitha shërbimet dhe të drejtat që parashikon ligji për Regjistrimin e Biznesit.

Duke shpresuar se do e mirëkuptoni kërkesën tonë, ju falënderoj për vëmendjen tuaj.

Sergio Fontana



President

CONFINDUSTRIA ALBANIA

Associazione degli Industriali Italiani in Albania
Sede: Rruga Themistokli Gërmenji, Pallati Frasheri, shkalla 1, ap 12, Tirana, Albania